

VENDIM
Nr.17, datë 7.1.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.998, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,
BURSAT E SHETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE, NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2009-2010”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 42 të ligjit nr.9357, datë 17.3.2005 “Për statusin e punonjësit të Shërbimit Informativ të Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a” e pikës 2.3 të vendimit nr.998, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) Fëmija, nxënës apo student, i punonjësit të Policisë së Shtetit, Forcave të Armatosura apo i Shërbimit Informativ të Shtetit, që ka humbur jetën në krye e për shkak të detyrës. Në fillim të çdo viti akademik, Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes dhe Shërbimi Informativ i Shtetit dërgojnë në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës listën emërore të tyre.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR-të/ZA-të dhe institucionet e arsimit të lartë e njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha